

SHOQERIA “Vis Petroleum” Sh.a
AKTIVITETI: SHPERNDARJA DHE MAGAZINIMI I NAFTAES DHE
NENPRODUKTEVE TE SAJ

PERMBLEDHJE NE GJUHE JO-TEKNIKE
SHPERNDARJA DHE MAGAZINIMI I NAFTAES DHE NENPRODUKTEVE TE SAJ
Narte-Vlore, Zona kadstrale 8605, nr.pasurie 6/175, Vlore.



Bazuar ne Ligjin 60/2014 Shtojca I “Per Lejet e Mjedisit” aktiviteti “Depozita te karburanteve”klasifikohet ne I.D 1.9 Shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj

Referuar Vendimit Nr. 419, date 25.6.2014, Kreu III Procedrat per shqyrtimin e kerkesave dhe percaktimi i kushteve per leje mjedisi te Tipit B, pika 1.dh Shoqeria “Vis Petroleum” aplikonper zhvillimin e procesit te degjeses me publikun, sipas pikes 13 te kreut VI te ketij vendimi.

Shoqeria “Vis Petroleum” Sh.a
Perfaqesuesi Ligjor i Shoqerise
Andi Muhametaj

PERMBLEDHJE JO-TEKNIKE

Shoqeria “Vis Petroleum” Sh.a aplikon per tu pajisur me Leje Mjedisi te Tipit B, per impiante dhe instalime ekzistuese, referuar VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja” te Ligjit Nr. 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit” Shtojca 1 (e ndryshuar) **“Industrite energjitike, ID 1.9. Shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj: a. Magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne cisterna te palevizshme ne ndonje terminal, ose ngarkimi/shkarkimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne/nga nje cisterne e levizshme, cisterne hekurudhore ose anije e ujerave te brendshme ne terminal. b. Shkarkimi naftes dhe nenprodukteve te saj ne cisternat e stacioneve te furnizimit me karburant.”, Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B: Te gjitha instalimet.**

Ne instalimin per shperndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenprodukteve te saj jane te punesuar 5 punonjes. Impianti eshte instaluar ne Narte-Vlore, Zona kadstrale 8605, nr.pasurie 6/175, Vlore,marre me qera nga subjekti “Vis Petroleum” Sh.a

AKTIVITETI: Shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj

Adresa: Narte-Vlore, Zona kadstrale 8605, nr.pasurie 6/175, Vlore,

Subjekti: “Vis Petroleum” Sh.a

1. Hyrje

Profili i shoqërisë “Vis Petroleum” për shperndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenprodukteve te saj

Instalimi per shperndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenprodukteve te saj të shoqërisë **“Vis Petroleum” sh.a** është i pozicionuar ne fshatin Narte-Vlore, Zona kadstrale 8605, nr.pasurie 6/175, Vlore. Kjo shoqëri është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për aktivitetin e Tregtim gazi me shumice, dhenie/marrje me qera te depozitave te gazit, tregtim me shumice I benzines, naftes, lubrifikanteve dhe te gjithë produktet dhe nenproduktet e tyre. Veprimtari sipermarrje industriale , ndertimi, tregtimi me shumice te mallrave te ndryshme. Import-eksport dhe çdo aktivitet tjetër te lejuar nga legjislacioni ne fuqi., me NR NIPT: L52305050U. Prona ku eshte ngritur linja e depozitave per shperndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenprodukteve te saj eshte ekzistuese, e marre me qera nga shoqeria “IRTC” SH.A..

Depozitat e tregtimit te karburanteve me nr RMV-2 te regjistruara prane Z.V.R.P.P Vlore me Zona kadstrale 8605, nr.pasurie 6/175 me siperfaqe totale 52 539 m2 nga ku vetem njera depozite , ajo e cituar si RMV-2.

Informacion mbi kompanine “Vis Petroleum” sh.a

Shoqeria **“Vis Petroleum” sh.a** eshte nje subjekt i regjistruar dhe zhvillon aktivitetin e saj ekonomik ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne fushen e shperndarjes dhe magazinimit te naftes dhe nenprodukteve te saj. Qellimi i firmes ka qene dhe mbetet permbushja e kerkesave te cilesise dhe per kete kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilesise ne te gjitha hallkat e prodhimit.

Shoqëria “**Vis Petroleum**” Sh,a ka nënshkruar kontratën e qerases me subjektin “IRTC” Sh,a, Nr. 1469 Rep, Nr. 465 Kol, datë 13.02.2017 objektin:

1. Depozitat e tregimit të karburanteve me nr RMV-2, të regjistruara pranë Z.V.R.P.P Vlore me Zona kadastrale 8605, nr.pasurie 6/175

2. Afati i kontrates është për 5 (pese) vjet, afat i cili ka filluar nga data 13.02.2017.

Depozitat e karburantit janë të pajisur me :

1. Leje Ndertimi me vendim të K.RR.T Bashkia Vlore për “Depozita Karburanti”

2. Leje përdorimi për objektin “Depozita Karburanti”

3. Certifikate për Mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi dt. 19.09.2016

4. Leje Mjedisore të meparshme nga AKM-ja PN-3823-09-2016”

3. Për këtë qëllim, subjekti “**Vis Petroleum**” sh.a referuar VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKBja” ka plotësuar Formularin e Kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisi të Tipit B për aktivitetin Shpërndarja dhe magazinimi i naftes dhe nenprodukteve të saj, me vendndodhje Zona kadastrale 8605, nr.pasurie 6/175.Subjekti ka siguruar staf dhe pajisje profesionale për zhvillimin e këtij aktiviteti.

Vendosja e këtij instalimi në këtë zonë është e pershtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi nuk përben shqetësim për banorët, ambienti është i rrethuar dhe ndodhet larg nga objektet apo veprat hidroenergjetike dhe qendrave të banuara, etj.

Qëllimi i këtij aktiviteti është shpërndarja dhe magazinimi i naftes dhe nenprodukteve të saj me qëllim

furnizimin e tregut rajonal të Tiranës dhe Durrësit me lëndë të parë hidrokarbure.

2. Të dhëna mbi impiantin e instaluar

Shoqëria “**Vis Petroleum**” sh.a si firmë me aktivitet në fushën e veprimtarisë së shpërndarjes dhe magazinimit të naftes dhe nenprodukteve të saj, ka investuar dhe disponon impiantet/makinëritë e domosdoshme për zhvillim të proceseve kryesore në shpërndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenprodukteve të saj. Objekti ku zhvillohet aktiviteti është një territor me hapsira të nevojshme për ushtrimin e këtij aktiviteti.

Karburantet vijnë në rrugë tokësore me autocisternë, në atë detare me anije të tipit cisternë.

Ruajtjen e tyre në rezervuarët përkatës, mbushjen e autocisternave, si dhe shpërndarjen e tyre në destinacionin e ruajtjes shoqërore përkatëse, është projektuar stacioni i mbushjes së autocisternave, duke përfshirë në përputhje me sasitë e produkteve të naftes dhe nenprodukteve të saj, kapacitetin e stacionit të furnizimit.

Mbushja e rezervuareve me produktet respective realizohet nëpërmjet stacionit të pompimit me pompa centrifugale.

Gjithashtu duke patur parasysh dhe mundësinë e pashmangshme të lindjes së rrymave elektrostatische gjatë levizjes së lëngut (produktit të naftes dhe nenprodukteve të saj) nëpër tubacione, rezervuarë, etj, gjatë proceseve të ngarkimit e shkarkimit, dukuri kjo e rrezikshme për lindjen e vatrave të zjarrit, në projekt janë marrë masa për evitimin e pasojave. Mbrojtja nga rryma elektrostatische të tubacioneve të linjave teknologjike të projektuara, realizohet përmes lidhjeve të konstruksioneve metalike të tyre, tek paisjet e sistemit të tokezimit. Rezistenca e kalimit të rrymës jo më shumë se 100 ohm.

Në kuadrin e mbrojtjes së objektit nga mundësia e lindjes së zjarrit, është parashikuar edhe mbrojtja e tij nga shkarkimet atmosferike. Të gjitha objektet, si rezervuarë cilindriqë vertikale

mbitoksore dhe ato me lartesi te madhe te ndodhura brenda territorit te sheshit te objektit te rezervuareve, si shtyllat e ndricimit me prozhektore, shtyllat e flamujve dhe ato te furnzimit me energji elektrike perfshihen ne sistemin e mbrojtjes, nga renia nen tension. Mbrojtja e rezervuareve realizohet me instalime te elektrodave te tokezimit te lidhura direkte me trupin e tyre, Stacioni i mbushjes se autocisternave per mbrojtje realizohet me tokezimin e konstruksionit metalik te tendes se mbulimit, Objekte te tjere, nyjet teknologjike te grup saracineskash, shtyllat e prozhektoreve, etj tokezohen duke u lidhur ne sistemin e mbrojtjes te nenobjekteve ne vecanti ose te objektit ne teresi.

Lista e objekteve

1. Roje e portes kryesore
2. Zyrat e administrates
3. Magazine e materialeve teknike dhe Oficine
4. Kabine elektrike dhe gjenerator
5. Porte rreshqitese elektrike
6. Porte me Kanata
7. Pike ngarkimi dhe shkarkimi
8. Parku i rezervuareve
9. Stacioni i pompave te benzines dhe gasoil
10. Stacioni i mbrojtjes nga zjarri
11. Impianti i pastrimit te ujerave te ndotur
12. Rrethimi i jashtem B.A dhe Rrjet teli H=3m

Prona ku zhvillohet aktiviteti eshte e rrethuar me mur betoni dhe respekton te gjitha distancat urbanistike per zhvillimn e aktiviteteve me karakter te tille.

Planvendosja e impiantit sipas Gaus Kruger Zone 4

Kordinatat e Terminalit per shperndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenprodukteve te saj		
Pikat	X	Y
1	4370838.10	4485098.08
2	4370839.34	4485091.26
3	4370831.39	4485105.00
4	4370852.25	4485101.01



Emri i Tregtar

“Vis Petroleum” Sh.a

Siperfaqe e sheshit te ndertimit 32 539 m²

Siperfaqja qe ze depozita 400 m²

Veprimtaria Shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj

Statusi shoqërisë Aktiv

Vendodhja e Aktivitetit Zona kadstrale 8605, nr.pasurie 6/175.

Kapaciteti depozitues 5000 m³

Në afërsi të zonës ku zhvillon aktivitetin subjekti “**Vis Petroleum**” Sh.a nuk ka shkolla, vepra arti, argjinatura, linjë elektrike të tensionit të lartë dhe linjë uji që mund të dëmtohen nga zhvillimi i aktivitetit për “**Shperndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenprodukteve te saj**”.

2.1 Menaxhimi i Instalimit

Menaxhimi I instalimit behet nga nje staf i kualifikuar dhe trajnuar per te operuar dhe per te ushtruar aktivitetin e shperndarjes dhe magazinimit te naftes dhe nenprodukteve te saj, per te cilin shoqeria “**Vis Petroleum**” operon ne tregun rajonal. Per zhvillimin e aktivitetit te kesaj shoqeria konform te gjitha rregullave, teknike, tatimore, fiskale dhe atyre mjedisore, eshte organizuar puna ne menyre te tille qe te funksionoje ne formen e nje organograme per realizimin sa me eficient dhe te sukseshem, e cila tregon menyren e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe pergjegjesive te secilit.

Përbërësit kryesorë të këtij programit per menaxhimin e mjedisit do të ndërthuren si më poshtë:

- Informacion i përgjithshëm;
- Mirëkuptim i informacioni të përgjithshëm i konceptit të qëndrueshmërisë dhe arsytet për një menaxhim mjedisor të mirë;
- Përdorimi i pajisjeve/aparatura të Certifikuara sipas Standartit Europian dhe Kolaudimi periodik i pajisjeve/aparaturave nga ekspertë të specializuar.
- Respektimi i orareve të punës brenda zonës ku zhvillohet veprimtaria
- Respektimi I masave teknike të punonjësve, sipas rregullores së brëndshme.
- Diferencimi dhe menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara nga kompani të liçensuara
- Trajtim dhe riciklim i ujrave teknologjike te gjeneruara nga instalimi
- Kapje e gazrave te gjeneruara nga instalimet
- Zhurmat do të jenë të përkoshme dhe tepër të ulëta duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës, sipas Udhëzimit Nr.8, dt 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”.
- Mirëkuptimi i potencialit të ndikimeve ambientale, që mund të priten nga faza kryesore e zhvillimit të aktivitetit;
- Funksionimi;
- Arsytet për propozimin e masave zbutëse;
- Vendosja në zinxhir e përgjegjësive dhe vendim marrja

- Trajnime specifike;

- Monitorimi i cilësisë ajrit;
- Monitorimi i cilësisë ujrave;
- Kriteri për vendosjen e stacioneve monitoruese;
- Metodologjitë që duhen përdorur për fushën e marrjes së mostrave;
- Trajnime në përdorimin e pajisjes dhe teknikat korrekte për ruajtjen e mostrës;
- Trajnim në laborator dhe rëndësia e cilësisë së sigurisë dhe metodat e kontrollit të cilësisë;
- Trajnim në gjetjen e mospërputhjes së situatave dhe procedurat që duhen ndjekur;
- Kërkesat e mjeteve që do t’ju kryhet shërbimi;

Plani i Përballimit të Emergjencave

Shoqëria “Vis Petroleum” Sh.a në veprimtarinë e saj, për aktivitetin “Shperndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenprodukteve te saj” , detyrohet të planifikojë, të organizojë dhe të realizojë me shpenzimet e veta dhe të shtetit shërbimet për përballimin e emergjencave civile në zonën ku zhvillohet veprimtaria.

Shoqëria ka për detyrë:

- Të hartojë plane për situatat e emergjencës civile dhe të zbatojë masat parandaluese në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Të njoftojë personelin si dhe autoritetet e Njesise Bashkiake Vendore për një rrezik imediat.
- Të organizojë, kur është e nevojshme, evakuimin e të punësuarve të tyre dhe të venë në veprim shërbimin e tyre në përgjigje të një situatë emergjence në zonën e tyre të veprimtarisë.
- Te nderhyje ne menyre te menjehershme ne rast te dukurive natyrore apo emergjencave
- Të sigurojë trajnimin për të punësuarit.

Emergjencat në këtë objekt, mund të vijnë nga këto shkaqe:

Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë

Objekti është i ndërtuar me planimetri të rregullt dhe ka respektuar kriteret teknike për funksionimin normal të tijë, duke respektuar me rigorizitet projektin teknik dhe kushtet e vendosura ne Lejen e Ndertimit. Ai ka sipërfaqe të mjaftueshme për kryerjen e proceseve të, operimit dhe funksionimit normal të instalimit, të lëvizjes së lirë të punonjësve, magazinimin e lëndës së parë, instalimin e shperndarjes dhe magazinimit te naftes dhe nenprodukteve te saj, disponon hapësira të mjaftueshëm për parkim, për të përballuar fluksin e ngarkim-shkarkimit të produktit dhe të klientëve, etj.

Evakuimi i detyruar i njerëzve në rast zjarri

Pozicioni i objekteve/instalimeve përbërëse të depozitave per shperndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenprodukteve te saj, sipas destinacionit që ato kanë, është i tillë që jo vetëm respekton largësitë e mbrojtjes nga zjarri, por në rast zjarri është i zgjidhur edhe evakuimi i detyruar i njerëzve dhe mjeteve prej tyre. Megjithate ne procese te tilla pune, renia e zjarrit ka shum pak gjasa te ndodhe. Nepermjet sensoreve te sigurise behet e mundur fikja e instalimeve ne rast te konstatimit te vatrave te zjarrit ne objektin ku zhvillohet veprimtaria.

Rënia nën tension

Duke u nisur nga specifika që ka puna, është marrë në konsideratë edhe mbrojtja nga rënia nëntension e paisjeve dhe e personelit që punon aty. E gjithë linja e shperndarjes dhe magazinimit eshte e togezuar dhe ne rastet e shkarkesave elektrike nga dukurite natyrore, i gjithë instalimi stakohet ne menyre automatike, qe kontrollohet nga panelii komandimit. Dhe për këtë rast janë parshikuar veprimet e menjëhershme që do të kryhen.

Nga tërmetet

Zona është e studiuar nga ana sizmike dhe bazamentet ku eshte ndertuar objektit dhe janë instaluar depozitat, pajisjet dhe instalimet, nuk përbëjnë rrezik për tërmetet. Kështu në rast tërmeti do të kishim vetëm lëkundje të tokës dhe nuk do të paraqesë rrezik për instalimin, objektet, personelin dhe për mjedisin përreth aktivitetit. Pavaresisht qe terreni ku jane instaluar depozitat eshte ne toke me bazament te bute, eshte projektuar qe ne fazat e par ate ndertimit

qendrueshmeria e bazamentit te terminalit, e gjithë ngarkesa qe shkarkohet percilet nepermjet plintave dhe pilotave duke vibruar valet ne brendesi te tokes.

□ **Nga përmbytjet**

Terminalet ku jane instaluar depozitat e shperndarjes dhe magazinimit te naftes dhe nenprodukteve te saj, për ushtrimin e aktivitetit jane te mbrojtur nga përmbytjet, rastet per permbytje te mundshme te instalimit kan pak gjasa qe te ndodhin. Ne afersi te objektit nuk ka burime ujore te cilat mund te shkaktojne permbytje te objektit.

Përreth objektit ekzistojnë kanale të mëdha drenazhuese për kullimin e ujrave të shiut dhe ujrave teknologjike qe sherbejne dhe ndihmojne kullimin e tokave perreth objektit.

□ **Sistemi i perballimit te emergjencave**

Gajte venies ne pune te ketij terminali te magazinimit dhe ruajtjes se karburanteve me shumice, jane marre masat e nevojshme per perballimin e emergjencave nga avarte e mundshme ne objekt. Ne gabim njerezor, apo nje defect teknik mund te shkaktoje nje rrjedhje te mundshme te karburanteve ne mjedisin e zones, nje gje e tille do te ishte me pasoja dhe efekte katrastofike per biodiversitetin ne mjedisin e zones, por edhe nje dem ekonomik teper te larte te shoqerise qe administron kete aktivitet.

Ndaj per te shmangur efekte te tilla, te cilat mund te mos ndodhin ndonjehere, por edhe nese ndodhin kane pak gjasa ne te ngjare, Subjekti ka zbatuar kushtet teknike te mbarefunksionimit (pasi eshte objekt ekzistues) te aktivitetit te shkarkimit dhe magazinimit te karburanteve me shumice.

Per kete subjekti ka marre te gjitha masat e nevojshme per rrethimin e perimetrit te zones ku ndodhen depozitat me mure betoni, si dhe jane marre te gjitha masat e nevojshme per mbajtjen e nje sasie te konsiderueshme te ujit per qellime te emergjencave nga zjarri.

Ne rastet e shkarkimit te karburanteve ne mjedisin e depozitave, ajo eshte lehtesisht e mbledhshme nepermjete elektropompave dhe mund te rifutet ne depozite te re, apo ne te njeften pas riparimit. Ne kete menyre shmanget mundesia e shkarkimit te karburantit ne mjedisin e zones, i cili per zonen ne vleresi eshte teper i ndjeshem dhe me vlera te larta te specieve dhe habitateve ne te, por edhe shmangia

e humbjes se nje sasie te madhe te karburantit, i cili eshte me vlere te larte monetare.

□ **Sistemi i sigurise dhe mbrojtja nga zjarri**

Aktivitete te tilla kane si perparesei madhore zbatimin rigoroz te kushteve teknike dhe ndertimin e sistemit te mbrojtjes se zjarrit (i cili eshte ekzistues dhe i ndertuar sipas specifikimeve teknike te PMNZSH).

Objekti ne vleresim, ne kete drejtim ka zbatuar me perrikmeri keto kerkesa, pasi ne objekt gjenden disa metoda dhe mjete te fikjes se zjarrit dhe te shuarjes se efektit shperthyes te depozitave

Nje depozite uji e cila sherben per depozitim e ujit, por edhe per efektin e shuarjes se vales goditese ne rastet e rrenies se zjarrit. Kjo depozite qendron vazhdimisht e mbushur me uje dhe ne gadishmeri te plote.

Pervec depozites se ujit, eshte ndertuar sistemi i hidranteve dhe i pompave hedhese te ujit, te cilat jane instaluar ne kater kende te ndryshme te perimetrit te depozitave. Keto pompa hehin ujin ne nje lartesi deri ne 90 m. Hidrantet jane te ndertuara cdo 50m dhe tubacioni i tyre arrin deri ne distancen 50 m.

Kolektori i zjarrit

Ne stacionin e kolektorit të zjarrit është instaluar një autogjenerator i cili është i pavarur nga sistemi I furnizimit me energji elektrike dhe nga sistemi i gjeneratoreve të përgjithshëm të objektit.

Sistemi i sigurisë fizike të objektit

Objekti është i rrethuar në mënyrë që pengon hyrjen e individëve të ndryshëm të pa autorizuar. Gjithashtu në çdo kënd të sheshit të depozitave (Terminaleve) ka të instaluar nga një kabine për vend-roje për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në objekt nga kompani të sigurimit fizik të licencuara.

Menaxhimi i prodhimit

Për mbrojtjen e instalimit nga bllokimi apo avaritë e ndryshme teknike rënia nën tension, rënia e zjarrit, bllokimi i impiantit/makinerve nga papastërtitë e lëndës së parë, lëvizja e punonjësve dhe mjeteve të transportit të brendshëm, etj janë marrë keto masa:

- Përreth terminaleve të depozitave ruhet distanca e sigurisë, e cila është vizuar me vijë të verdhë, përgjatë këtij perimetri lëvizin vetëm drejtuesit teknik dhe punonjësit e autorizuar
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve të ngarkimit dhe shkarkimit të lëndës së parë si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Është instaluar sistem i ujitjes për mjedisin përreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar për shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në objekt nga kompani të sigurimit fizik të licencuara.

Menaxhimi i prodhimit

Për mbrojtjen e instalimit nga bllokimi apo avaritë e ndryshme teknike rënia nën tension, rënia e zjarrit, bllokimi i impiantit/makinerve nga papastërtitë e lëndës së parë, lëvizja e punonjësve dhe mjeteve të transportit të brendshëm, etj janë marrë keto masa:

- Përreth terminaleve të depozitave ruhet distanca e sigurisë, e cila është vizuar me vijë të verdhë, përgjatë këtij perimetri lëvizin vetëm drejtuesit teknik dhe punonjësit e autorizuar
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve të ngarkimit dhe shkarkimit të lëndës së parë si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Është instaluar sistem i ujitjes për mjedisin përreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar për gjelberim si dhe pozicioni që ato kanë) si dhe lagësia me ujë e rrugicave të brendshme gjatë periudhës Maj-Tetor, ujrati e pastrimit do të shkarkohen në rrjetin e brendshëm të kullimit dhe nga aty në pusët dekantuese, dhe me pas në rrjetin e kanalizimeve të zonës, këto ujra nuk janë të ndotura më lëndë me përbërje të rrezikshme.
- Brenda objektit kryhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat janë; lende të aballazheve, letrakartona, qelqe, si dhe lende organike të gjeneruara nga punonjësit, këto mbetje grumbullohen dhe periodikisht depozitohen në vendin e caktuar nga Njësia Vendore ku janë vendosur kosha selektive.
- Mbetjet e rrezikshme me përmbajtje hidrokarbure, të cilat gjenerohen nga operacionet e shpërndarjes dhe magazinimit të lëndës së parë naftë dhe nënproduktet e saj, grumbullohen dhe depozitohen në depozita/fucia të padertueshme dhe ruhet në kushte të përshtatshme atmosferike deri në rikuperimin dhe asgjësimin përfundimtar të tyre nga subjekte të licencuara.
- Instalimet dhe depozitat janë tokëzuar dhe i gjithë sistemi është i lidhur me kutinë qendrore të shpërndarjes e cila është e siguruar me çelësin e sigurisë, për çfarëdo lloji avarie të mundshme.
- Pajisjet e reja janë me të avancuara dhe një sërë veprimesh i kanë të automatizuara duke shmangur kështu ndërhyrjen e punonjësve dhe të punuarit pranë tyre, për veç të tjerash shoqëria ka disa rregulla strikte të cilat zbatohen me rigorozitet për mos ndërhyrjen në makineri gjatë

punes, stakimit te energjise para fillimit te kontrollit apo mirembajtjes e remontit te tyre, etj.

Sigurimi teknik në proceset e punës

Zbatimi i normave të rregullores së teknikës së sigurimit

Gjatë ushtrimit të aktivitetit për shperndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenprodukteve te saj subjekti mban parasysh që problemet e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë janë më të rëndësishmet dhe më të mprehta dhe kërkojnë vlerësim serioz.

- Para se gjithash në të gjitha operacionet jane punësuar specialist me eksperience pune në kryerjen e proceseve të ndryshme të përdorimit të instalimeve dhe pajisjeve
- Rregullore e Teknikës së Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik të drejtimit te operacioneve, zbatohet në çdo proces pune të përcaktuar në plan organizimin e kryerjes së punimeve të hartuar nga ai dhe të miratuar nga drejtuesit e firmës.
- Plan organizimi i punimeve/prodhimit hartohet para fillimit të cdo operacioni te funksionimit te linjes se prodhimit.
- Plan organizimi i punës hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve
- Drejtuesi teknik i punimeve ose personi i ngarkuar ben kontrollin teknik dhe azhornimin e saktë të punimeve/shperndarjes/magazinimit të cdo lloji për të cilat subjekti eshte licensuar.
- Rradha e kryerjes se veprimeve përcaktohet hollesisht në planin e masave tekniko organizative dhe eshte i miratuar nga përfaqësuesi i shoqërisë.
- Në këtë plan tekniko-organizativ masat e teknikes së sigurimit zenë vendin kryesor.
- Drejtuesi teknik i punimeve kryen instruktme të rregullta mujore e tre mujore , ku trajtohen tema të vecanta për të gjitha profesionet dhe operacionet qe zhvillohen brenda instalimeve per shperndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenprodukteve te saj.
- Kujdes i vecantë tregohet në krijimin e kushteve të punës , pastrimit të objektit dhe instalimit dhe monitorimit te parametrave mjedisore, etj.
- Kujdes i veçantë i kushtohet ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit të zones

Masa të tjera lehtësuese, për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e shperndarjes dhe magazinimit te karburanteve:

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë decorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum perdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të kryhet rrethimi i objektit dhe linjës së depozitimit te karburanteve dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulet.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e Mbetjet e rrezikshme me permbajtje hidrokarbure te Rikuperohen dhe asgjesohen nga subjekte te licencuara.

- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të respektojë të gjitha masat/normat/planet/shkarkimet e deklaruara në këtë Formular-Kërkese për Leje Mjedisore Tipi B.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset.
- Të kryhet monitorimi i indikatorëve të mjedisit sipas ligjeve në fuqi.
- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoj ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmëndura më sipër.
- Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga linja e prodhimit.
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjith kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshëm si gjatë fazës së depozitimit të karburanteve të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

Masa lehtësuese të tjera të kërkuara

- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Subjekti të kryej aktivitetin për shpërndarjen dhe magazinimin e naftes dhe nenproduktet e saj vetëm brenda kordinatave të sipërfaqes së tokës që disponon me qera.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.
- Do të instalohet sistem i ujitjes për mjedisin përreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar për gjelbërim si dhe pozicioni që ato do të kenë) si dhe lagia me ujë e rrugicave të brëndshme gjatë periudhës Maj-Tetor.
- Linja e Impiantit të instaluar në objekt, do të koluadohet në mënyrë periodike nga teknikë të specializuar dhe certifikuar për të tilla procese.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe efikasitetit që kanë në kryerjen e operacioneve depozitimit të karburanteve
- Maksimizimi i përdorimit të lëndës së parë
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjieno-Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të aballazheve, letra-kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit dhe klientat, ku këto mbetje do të transportohen

rregullisht në vendin e caktuar nga Njesia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selective sipas rrymave specifike të mbetjeve.

Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike dhe ujit të shiut në këtë

objekt ose e mjedisit përreth drejt mjedisëve të gjobëruara, një mundësi e mirë dhe për vaditje dhe

shmangie të derdhjes së tyre në mjedis si dhe shmangie të përdorimit të ujit të pijshëm për vaditje.

Mjedis i gjëlberuar përreth do të jetë nën kujdesjen e personelit që do të punësohet vetëm për punimet agro-mjedisore të nevojshme.

BAZUAR NË LIGJIN 10 440, DATE 7.7.2011 “PER VLERESIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS” AKTIVITETI “SHPERNDARJA DHE MAGAZINIMI I NAFTAES DHE NENPRODUKTEVE TE SAJ” NUK KERKON VLERESIM TE NDIKIMIT NE MJEDIS SIPAS SHTOJCES I DHE II “PROJEKTET QË I NËNSHTROHEN PROCEDURËS SË THELLUAR TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS DHE PROJEKTET QË I NËNSHTROHEN PROCEDURËS PARAPRAKE TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS”, PASI OBJEKTI ESHTË EKZISTUES , ME LEJE NDERTIMI (DEPOZITA KARBURANTI), KU REFERUAR PIKES 2, TE NENIT 4, TE LIGJIT 10 440, DATE 07.07.2011 “PER VLERESIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS”, KY AKTIVITET ESHTË I NDERTUAR DHE NUK KERKON TI NENSHTROHET PROCEDURES SE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDISI”. PER SA ME LART SUBJEKTI “Vis Petroleum” SH.A ME AKTIVITETIN E TIJ “SHPERNDARJA DHE MAGAZINIMI I NAFTAES DHE NENPRODUKTEVE TE SAJ” APLIKON PER TU PAJISUR ME LEJE MJEDISI TE TIPIT B, REFERUAR KREUT III, TE VENDIMIT NR. 419, DATE 25.6.2014, “PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE TË POSAÇME PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPAVE A, B DHE C, PËR TRANSFERIMIN E LEJEVE NGA NJË SUBJEKT TE TJETRI, TË KUSHTEVE PËR LEJET RESPEKTIVE TË MJEDISIT, SI DHE RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR SHQYRTIMIN E TYRE NGA AUTORITETET KOMPETENTE DERI NË LËSHIMIN E KËTYRE LEJEVE NGA QKB-JA” SIPAS SHTOJCES I, TE LIGJIT 60/2014, DATE 25.6.2014 “PER LEJET E MJEDISIT” (TE NDRYSHUAR) PER VEPRIMTARINE ME I.D 1.9 SHPERNDARJA DHE MAGAZINIMI I

NREFERUAR KREUT III “PROCEDURAT PER SHQYRTIMIN E KERKESAVE DHE PERCAKTIMIN E KUSHTEVE PER LEJE MJEDISI TE TIPIT B” PIKA 1.DH TE VENDIMIT NR. 419, SUBJEKTI “Vis Petroleum” SH.A APLIKON PER ZHVILLIMIN E DEGJESES ME PUBLIKUN, SIPAS PIKES 13 TE KREUT VI TE KETIJ VENDIMI.

**Perfaqesuesi Ligjor i Shoqerise “VIS PETROLEUM” Sh.a
Andi MuhametajAFTES DHE NENPRODUKTEVE TE SAJ.**